



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 541, datë 05.11.2020

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATAT
E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONET E LIRA
TË SHPALLURA ME VENDIMET E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR TË
DATËS 07.10.2020

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.389, nr.392, nr.394, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. Lutfije Celami - relator z.Alban Toro;
2. Për kandidaten znj. Luveda Dardha - relatores znj. Marçela Shehu;
3. Për kandidaten znj. Marsela Dervishi - relator z. Ilir Toska;
4. Për kandidaten znj. Rezarta Aliu (Paja) - relatores znj. Marçela Shehu;
5. Për kandidatin z. Sokol Pina - relator z.Alban Toro.

3. Për kandidatët z. Engert Pëllumbi, znj. Irida Kacerja dhe znj. Migena Laska, të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit ose në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, respektivisht për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 392, nr. 394 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 394 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, për kandidatin z. Sokol Pina, në kushtet e tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione, më datë 29.10.2020.

5. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 391 dhe nr. 393, datë 07.10.2020, në kushtet e tërheqjes nga kandidimi, më datë 29.10.2020, për këto pozicione, të kandidatit të vetëm z. Sokol Pina.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR